

VENDIM
Nr. 182, datë 25.3.2021

PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA PROJEKTI “RIKUALIFIKIM URBAN I BLOKUT NR. 1, LAGJJA NR. 2, CËRRIK”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti “Rikualifikim urban i bllokut nr. 1, lagjja nr. 2, Cërrik”.

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Cërrik.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, në shumën e përgjithshme prej 545 580 (pesëqind e dyzet e pesë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 545 580 (pesëqind e dyzet e pesë mijë e pesëqind e tetëdhjetë) lekësh, të përballohet nga Bashkia Cërrik.

5. Vlera për shpenzimet procedurale, në shumën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohet nga buxheti i vitit 2021, miratuar për Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë.

6. Afati i përfundimit të shpronësimit të jetë brenda tre muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, të kompensohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur certifikatën e pronësisë, kartelën e pasurisë, si dhe hartën treguese të regjistrimit, në zyrat e Bashkisë Cërrik.

8. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Cërrik.

9. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, në bashkëpunim me Bashkinë Cërrik, të fillojnë procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale të regjistrimit, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të Bashkisë Cërrik.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të pezullojë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen procesi i hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë në favor të Bashkisë Cërrik.

11. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Cërrik dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

TABELA PARAPRAKE ME LISTËN E PRONARËVE TË PASURIVE PRONË PRIVATE DHE
VLERAT E SHPRONËSIMIT, PËR REALIZIMIN E PROJEKTTIT “RIKUALIFIKIM URBAN I
BLLOKUT NR. 1 , LAGJJA NR. 2, BASHKIA CËRRIK”

Nr.	Emër,biemër	Zona kadastrale	N./pasurisë	Lloji i pronës	Njësia	Sasia	Vlera e objektit të shërbimit sipas situacionit (lekë)	Vlera totale (lekë)	Konfirmimi nga ASHK Elbasan
1	Nail Hazbi Shabani	1389	4/87/2	Ndërtesë	m²	36	392,530	392,530	Konfirmuar nga ASHK Elbasan, urdhër kufizimi.
2	Nazmi Ramis Kerkapi	1389	4/112-ND	Ndërtesë	m²	18	153,050	153,050	Konfirmuar nga ASHK Elbasan, urdhër kufizimi.
VLERA PARAPRAKE E SHPRONËSIMIT NË TOTAL						54		545,580	

Shënim. Vlerësimi për pasuritë e llojit “ndërtesë” është bërë sipas VKM-së nr. 138, datë 23.3.2000, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar.